

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Trepça SH.A.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **12997 12998-26-538-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me bateri traksionare për lokomotiva**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	EMC Engineering Maintenance Center SH.P.K.
NUI	812134310
Adresa	Magjistranja Prishtine-Lipjan,Rr.Ibrahim Rugova,PN
Vendi	Lipjan
Kodi postar	1400
Numri Telefonit	+355692055661
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Agron Çopja
Adresa elektronike	a.copja@emc.com.al
Data e parashtrimit të ankesës	10.04.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me bateri traksionare për lokomotiva

Ankesë kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së (B58) të datës 27.03.2026 dhe refuzimit të kërkesës për rishqyrtim. Pretendojmë se OE i shpallur fitues nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit dhe se gjatë vlerësimit janë shkelur dispozitat e LPP-së.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Po.

Me datë 31.03.2026 kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues lidhur me Vendimin mbi rezultatin e tenderit.

Autoriteti Kontraktues me datë 01.04.2026 ka nxjerrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim si të pabazuar.

Kopja e vendimit të AK-së është bashkëngjitur në këtë ankesë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Të pakënaqur me Vendimin e Autoritetit Kontraktues për rezultatin e aktivitetit të prokurimit, parashtrajmë këtë ankesë kundër Njoftimit mbi Vendimin (B58) të datës 27.03.2026, si dhe Vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të datës 01.04.2026.

Pretendojmë se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik, përkatësisht:

- Neni 7 – Barazia në trajtim dhe jo-diskriminimi;
- Neni 56 – Dispozitat e përgjithshme mbi përzgjedhjen dhe dhënie të kontratës;
- Neni 59 – Vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i tenderëve.

Këto shkelje kanë ndodhur gjatë procesit të vlerësimit, krahasimit të tenderëve dhe gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues ka bërë trajtim jo të barabartë duke shpallur fitues OE “Profitech” sh.p.k, përkundër faktit se oferta e tij nuk i plotëson kërkesat e dosjes së tenderit.

Në këtë mënyrë është favorizuar një operator ekonomik me ofertë të papërgjegjshme, ndërsa oferta jonë është eliminuar, duke përbërë shkelje të nenit 7 të LPP-së.

OE “Profitech” sh.p.k nuk ka përmbushur kërkesat e detyrueshme të dosjes së tenderit.

Konkretisht:

- Nuk ka dorëzuar specifikim teknik të detajuar sipas Aneksit 1;
- Nuk ka dorëzuar certifikatën IEC 62973 ose IEC 60254-1;
- Katalogu nuk përmban identifikim të produkteve;
- Nuk është dëshmuar jetëgjatësia minimale prej 1800 cikleve (ofron vetëm 1500 në 80% DoD);

- Nuk ka dëshmi për staf të certifikuar nga prodhuesi.

Këto janë kërkesa obligative dhe mungesa e tyre e bën ofertën të papërgjegjshme.

Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësim të gabuar duke shpallur fitues një ofertë që nuk përmbush kërkesat e tenderit.

Sipas nenit 59 të LPP-së, vetëm ofertat që përmbushin të gjitha kërkesat mund të konsiderohen të përgjegjshme.

Në këtë rast, AK ka vepruar në kundërshtim me këtë dispozitë duke mos eliminuar OE “Profitech”.

Edhe OE “Auto Kosova” nuk i plotëson kërkesat e tenderit.

Janë konstatuar:

- Dy certifikata biznesi me numra të ndryshëm;
- Mospërputhje në emrin e përfaqësuesit;
- “Specifikimi teknik” është vetëm kopje e dosjes së tenderit;
- Katalogu nuk identifikon produktet;
- Dimensionet teknike nuk përputhen;
- Mungojnë standardet IEC dhe dëshmitë për ciklet;
- Mungon dëshmi për staf të certifikuar.

Kjo ofertë gjithashtu është e papërgjegjshme.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Operatori ekonomik ka pësuar dëme materiale në vlerë prej 500 euro për përgatitjen e kërkesës për rishqyrtim dhe ankesës në OSHP.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,

- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*